

## Aktivite Ndergjegjesimi të organizuara nga NOPIU

### NOPIU ka organizuar shumë aktivitete ndërgjegjësimi

1. Ndër këto më të rëndësishmit janë aktivitetet për Ditën Ndërkombëtare të Ozonit 16 Shtatorit.


- Më poshtë jepen foto nga dita nderkombetare e Ozonit 2007 qe perkonte dhe me 20 vjetorin e Protokollit të Montrealit



Gjatë këtij aktiviteti janë shpërndarë fletë – palosje, dhe bluza me Ozonin. ( këto duken edhe ne fotot e mësipërme )



- Fotoja e mëposhtme tregon për aktivitetin e organizuar nga NOPIU Diten e Ozonit Shtator 2006.




- Fotoja e mëposhtme tregon për aktivitetin e organizuar nga NOPIU Diten e Ozonit Shtator 2004.





2. Botimi i disa librave dhe revistave si edhe përgatitja e disa CD me materiale të ndryshme të seminareve që kemi zhvilluar, të cilat jepen më poshtë:

- **Librat dhe revistat**





• CD – të



1. Gjithashtu janë botuar disa artikuj në numra të ndryshëm të revistës Mjedisi Shqiptar, revistë periodike e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Këta artikuj janë edhe më poshtë:

**Situata Aktuale ne Shqiperi dhe Plani Kombetar per Heqjen nga Perdorimi te Substancave qe Hullojne Shtresen e Ozonit.**

**Pergatitur nga Gazmend Gjyli , NOPIU .**

Shqiperia nuk ka prodhuar ODS. Keto substanca jane importuar gjithmone. Renia e regjimit totalitar dhe rihapja e kufijve ka ndryshuar rrenjesisht karakteristikat e konsumimit te pajisjeve qe perdorin ODS dhe vete ODS-te. Ne tabelen1 jepet konsumi i ODS ne vitin 2001

**Tabela 1** : Konsumimi i ODS me 2001, tone ODP

|                             | f t o h j a |            |                            |             | i<br>air-condition<br>makina | solvente    | Totali<br>ODP,<br>ton | ODP   |
|-----------------------------|-------------|------------|----------------------------|-------------|------------------------------|-------------|-----------------------|-------|
|                             | thtepiake   | tregtare   | industriale<br>(magazinim) | transporti  |                              |             |                       |       |
| <b>Aneksi A</b>             |             |            |                            |             |                              |             |                       |       |
| Grupi I                     |             |            |                            |             |                              |             |                       |       |
| CFC-12                      | 52.8        | 8.9        | 0.99                       | 1.32        | 3.9                          | 0.0         | 68                    | 1.000 |
| CFC-115                     | 0.1         | 0.5        | 0.2                        | 0.0         | 0.0                          | 0.0         | 0.8                   | 0.600 |
| <b>Totali per Aneksin A</b> | <b>52,9</b> | <b>9,4</b> | <b>1,19</b>                | <b>1,32</b> | <b>3,9</b>                   | <b>0,0</b>  | <b>68,8</b>           |       |
| <b>Aneksi B</b>             |             |            |                            |             |                              |             |                       |       |
| Grupi II                    |             |            |                            |             |                              |             |                       |       |
| Tetraklorur karboni         | 0.0         | 0.0        | 0.0                        | 0.0         | 0.0                          | 1,16        | 1,16                  | 1.100 |
| Grup III                    |             |            |                            |             |                              |             |                       |       |
| Metil kloroform             | 0.0         | 0.0        | 0.0                        | 0.0         | 0.0                          | 0.5         | 0.5                   | 0.100 |
| <b>Totali per Aneksin B</b> | <b>0,0</b>  | <b>0,0</b> | <b>0,0</b>                 | <b>0,0</b>  | <b>0,0</b>                   | <b>1,66</b> | <b>1,66</b>           |       |
| <b>ANEKSI C</b>             |             |            |                            |             |                              |             |                       |       |
| Grupi I                     |             |            |                            |             |                              |             |                       |       |
| HCFC-22                     | 0.4         | 0.4        | 0.2                        | 0.0         | 0.0                          | 0.0         | 0.9                   | 0.055 |
| <b>Totali per Aneksin C</b> | <b>0,4</b>  | <b>0,4</b> | <b>0,2</b>                 | <b>0,0</b>  | <b>0,0</b>                   | <b>0,0</b>  | <b>0,9</b>            |       |
| <b>Totali konsumit</b>      | <b>53,3</b> | <b>9,8</b> | <b>1,39</b>                | <b>1,32</b> | <b>3,9</b>                   | <b>1,66</b> | <b>71,4</b>           |       |

**Konsumimi i ODS**

Sektoret kryesore qe konsumojne ODS (substancia demtuese te ozonit) ne Shqiperi mund te ndahen ne gjashte grupe:

- Frigoriferet shtepiake
- Frigoriferet Industriale
- Ngriresit Komerciale
- Furgonat Frigorifere
- Kondicioneret e Ajrit
- Serviset e pastrimit te frigorifereve dhe kondicionereve te ajrit

**Frigoriferet Shtepiake**

Nuk ka prodhim te frigoriferave shtepiake ne Shqiperi. Sasia totale e frigorifereve ne 1990 nuk e kalonte 100000. Eshte llogaritur qe numri i frigorifereve shtepiake ne Shqiperi deri ne vitin 2001 ishte 728000. Shumica e tyre jane frigorifere shtepiake te dores se dyte. Pothuajse shumica e tyre perdorin R-12. Ata jane 10-15 vjecare. Norma vjetore e riparimit te tyre eshte vleresuar te jete jo me pak se 33%.

**Frigoriferet Industriale**

Frigoriferet industriale perfaqesohen nga frigoriferet e mishit, peshkut, birres etj nga dhomat e ftohta ne fabrikat respektive etj. Ne te kaluaren frigoriferet industriale kane qene njesi te medha qe punonin ne amoniak (tashme jashte funksionimit) dhe njesi me te vogla te mbushura me CFC-12. Frigoriferet e rinj industriale funksionojne me R-22.

Sasia totale e CFC-12 te instaluar ne frigoriferet industriale eshte baraz me 3.65 tone.

Numri i frigorifereve industriale eshte 360 njesi ne Shqiperi.

**Frigoriferet Tregtarë**

Shume frigorifere te dores se dyte perfaqesojne kete kategori frigoriferesh te perdorur kryesisht ne dyqane, markete, bare, kafe restorante etj. Eshte evidentuar qe shumica tyre perdorin R-12. Pak perdorin R-22 dhe R-502.

## **Furgonat Frigorifere**

Jane llogaritur qe te jene rreth 400 njesi qe perdorin pothuajse te gjitha R-12.

## **Kondicioneret e ajrit**

Ata perdorin pothuajse te gjitha R-22.

## **Serviset e Frigorifereve dhe Kondicionereve te ajrit**

Rreth 196 servise frigoriferesh dhe kondicioneresh kryejne kete lloj biznesi. Nje nga perdoruesit kryesore te R-12 jane serviset kryesisht te frigorifereve shtepiake, ku ata mblidhen per t'u riparuar dhe mbushur me ODS, vecanerisht me R-12. Keta servise jane evidentuar me numer dhe sipas rretheve te ndryshem te Shqiperise.

**Fabrika e Oksigjenit e Kombinatit Metalurgjik te Elbasanit** Fabrike Oksigjeni e Kombinatit Metalurgjik te Elbasanit, konsumon rregullisht tetraklorur karboni, i cili eshte nje ODS.

## **Sfungjeret (Shkumat)**

Rezultatet e mbledhjes se te dhenave treguan se asnje prodhues sfungjerash ne Shqiperi nuk perdor ODS.

## **Tymosetit**

Perpara 1990 eshte perdorur CCl<sub>4</sub> per disinfektimin e kafsheve ne ferma dhe bromuri metilit per tymosjen e e serrave dhe per duhanin. Por nga 1990-2000 ai nuk eshte me ne perdorim. Per ringjalljen e bujqesise po kerkohen alternative te tjera.

## **Perdoruesit kryesore te ODS ne Shqiperi duket se jane frigoriferet shtepiake. Ky sektor perdor pothuajse totalisht R-12.**

Analizat e te dhenave sygjerojne se Shqiperia nuk ka mundesi per te permbushur objektivat e Protokollit te Montrealit, por mund te permbusha objektivin final.

Takimi i 14-te i paleve shenoi se Shqiperia ratifikoi Konventen e Vienes mbi Mbrojtjen e Shtreses se Ozonit dhe tekstin e konsoliduar te Protokollit te Montrealit ne Tetor 1999 dhe vendi eshte klasifikuar si nje pale qe funksionon sipas nenit 5 ne protokoll.

Komiteti Ekzekutiv i Fondit Multilateral per Implementimin e Protokollit te Montrealit aprovoi Planin Kombetar per Substancat Demtuese te Ozonit (NPOP) nepermjet Vendimit te tij nr. 39/43.

Komiteti Ekzekutiv ka shenuar gjithashtu si vazhdim i Vendimit Nr. XIV/18, qe Shqiperia ka parashtruar ne Sekretariatin e Ozonit per t'u vleresuar nga Komiteti i Implementimit nje plan perfundimtar qe permbush CFC Freeze ne 2005 dhe 50% reduktim ne 2006.

Ne menyre qe te sigurohet ndihme e menjehershme per te permbushur P.M., Komiteti Ekzekutiv ka lidhur nje marreveshje me Qeverine Shqiptare per kompletimin heqjes se substancave demtuese te ozonit (ODS) te Aneksit A grupi I, Aneksit B Grupi II dhe Aneks E te perdorura ne Shqiperi.

Shqiperia pranon perdorimet e kontrolluara te te gjitha ODS ne perputhje me limitet e konsumit vjetor treguar ne Tabelen 3.

**Tabela 3: Limitet vjetore te konsumimit te ODS ne Shqiperi**

| Viti                    | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 |
|-------------------------|------|------|------|------|------|------|------|
| Konsumi i ODS, ton/ vit | 68.0 | 61.2 | 36.2 | 15.2 | 6.2  | 2.2  | 0    |

Si rrjedhoje e permbushjes se detyrimeve te Shqiperise te vendosura ne marreveshje, Komiteti Ekzekutiv i Sekretariatit te Ozonit ka rene dakord ne parim te siguroje nje total prej 653,125 USD, duke perjashtuar kostot e mbeshtetjes se agjencive zbatuese dhe financimin per Forcimin Institucional, si financim per kompletimin e heqjes se te gjitha ODS , sipas skedimit te disbursimit te financimit te paraqitur ne Tabelen 4.

Si pjese e NPOP, Komiteti Ekzekutiv aprovoi financimin e nen-projekteve te meposhtme:

-Manaxhim e Auditim Programi, me kosto 16068 USD (UNIDO)

-Trainim i Doganierëve per Kontrollin e ODS, kosto 35700 USD (UNEP)

- Trainim i Trainereve per Praktikave te mira per Ftohjen, kosto 82425 (UNEP)
- Rrjeti i riciklimit frigoriferik, me nje kosto prej 100000 USD (UNIDO)
- Shnderimi i Impiantit te Pastrimit nga me tetraklorur karboni ne tetrakloretilen ne Kombinatin e Elbasanit me nje kosto prej 45000 USD (UNIDO)
- Nje workshop ndergjegjesimi per Ndalimin e futjes se Bromurit te metilit, me nje kosto prej 20000 USD (UNIDO).

Nga tabela 3 del evidente se Shqiperia nuk do te kete mundesi qe te reduktoje nivelin 50% ne 2005. Qysh kur filloi implementimi ne 2003, eshte e pamundur qe te arrihet nje reduktim ne konsumimin e rreth 48 toneve (konsumi aktual eshte 68 tone ODP dhe sipas Protokollit te Montrealit konsumi ne Shqiperi ne 2005 duhej te ishte 20 tone ODP).

Mbi bazen e informacionit ne 2005 Shqiperia duhet te arrije nje reduktim prej me teper se 50% (nga 68 ne 36.2 tone ODP) ne konsumimin e ODS-ve. Sidoqofte me 2007, Shqiperia do te arrije nje reduktim te me teper se 90% te konsumit te tyre aktual. Gjithashtu, ajo do te arrije nje faze perfundimtare me 2008 per te permbushur objektivin e Protokollit .

### **Ndikimi i veprimeve te ndryshme ne Planin Perfundimtar**

Tabela 4 tregon ndikimin e priteshem te veprimeve te ndryshme ne pakesimin e ODS-ve gjate periudhes se implementimit te NPOP 2003-2010.

**Tabela 4:** Ndikimi i projekteve te ndryshme per reduktimin e ODP (kuotat e importuara) gjate periudhes se implementimit te NPOP.

| <b>Viti i projektit</b>                              | <b>2003</b> | <b>2004</b> | <b>2005</b> | <b>2006</b> | <b>2007</b> | <b>2008</b> | <b>2009</b> | <b>2010</b> |
|--|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Trainimi i teknikeve</b>                          | 6,8         |             |             |             |             |             |             |             |
| <b>Trainimi Doganierëve &amp; sistemi licensimit</b> |             | 3           | 3           | 3           |             |             |             |             |
| <b>Riparimi &amp; Riciklimi</b>                      |             | 20          | 10          | 2           |             |             |             |             |
| <b>Retrofiti</b>                                     |             | 2           | 5           | 4           | 4           | 2,2         |             |             |
| <b>Projekti i solventeve</b>                         |             |             | 3           |             |             |             |             |             |
| <b>Kuotat e importit</b>                             | 68          | 61,2        | 36,2        | 15,2        | 6,2         | 2,2         | 0           | 0           |

Qeveria e Shqiperise eshte plotesisht e ndergjegjshme se nuk eshte konform P.M. dhe duhet qe urgjentisht te ndermarre hapat e nevojshem qe te plotesoje kerkesat e atij Protokollit me qellimin final te kompletimit te fazes perfundimtare me 2008.

Ajo po perpunon politika te duhura per te reduktuar kerkesen per ODS. Legjislacioni perkates i Shqiperise per ambientin perfaqesohet nga Ligji per Mbrojtjen e Ambientit i miratuar me 1993 dhe ndryshuar me 1998. Ligji i Mbrojtjes se Ajrit eshte miratuar me 2002 dhe eshte ne fuqi. Keto ligje konstituojne bazat legale per zhvillimin e rregullave te ndryshme per kufizimin e perdorimit te ODS-ve dhe per arritjen e fazes perfundimtare.

Gjate kesaj periudhe, struktura e Njesise Kombetare te Ozonit po kompletohet si nje Njese Kombetare e Ozonit dhe Implementimit te Projekteve – NOPIU.

Pas procesit te informacionit eshte pergatitur Projekt Ligji mbi Mbrojtjen e Shtreses se Ozonit.

Po punohet me doganat dhe tatim taksat per monitorimin e ODS-ve.

Per te perfshire inspektorët rajonale te ozonit ne procesin e monitorimit eshte e nevojshme te fillohet implementimi i “Programi i Manaxhimit dhe Kontrollit”.

Aktualisht jemi ne fazen e fillimit te implementimit te disa projekteve, qe kane impakt te rendesishem ne NPOP.

Ne kuadrin e Projektit te Forcimit Institucional jane zhvilluar disa aktivitete per ndergjegjesimin e publikut, si poster per diten e ozonit , nje artikull qe eshte ne faze publikimi etj.

## **Mjedisi Shqiptar Nr 2/2003**

### **Artikulli 2**

**Disa Projekte per Mbrojtjen e Shtreses se Ozoni  
Përgatitur nga Valbona PLAKU, NOPIU**

Shqipëria ka ratifikuar dokumentat e Konventës së Vienës dhe Protokollit të Montrealit në 8 Tetor 1999 dhe duke filluar prej 7 Janarit 2000 është palë me to.

Nga qenia palë në Konventën e Ozonit buron dhe detyrimi i Shqipërisë për raportimin e konsumit në vite të substancave ozon – holluese, si dhe zbatimin e kuotave të caktuara nga Protokollit i Montrealit. Prej vitit 2001 Shqipëria ka Planin Kombëtar të Ozonit, në të cilin përfshihet Plani Kombëtar i Heqjes nga Përdorimi i Substancave që Hollojnë Shtresën e Ozonit. Plani Kombëtar u hartua nga Ministria e Mjedisit me asistencën e Agjensive Implementuese, UNEP – it dhe UNIDO –s.

Me asistencën e agjensive implementuese siç është UNEP – i dhe UNIDO, Shqipëria ka filluar zbatimin e disa projekteve me qëllim realizimin e objektivave të Protokollit të Montrealit. Disa nga këto projekte kanë përfunduar.

Këto projekte janë:

## **1. Trainimi i Teknikëve me Praktikat e Mira të Ftohjes.**

Trainimi në vend i trainierëve me praktikat e mira të ftohjes ka si synim rritjen e aftësive profesionale me këmbimin e përvojës vendore si një pjesë vitale e NOPIU – t dhe si qëllim kryesor pakësimin e përdorimit të sasive të reja të LHO – ve në sektorin e frigoriferëve dhe kondicionerëve të ajrit.

Kjo do të japi bazën për zbatimin e një praktike të mirë mirëmbajtje në sektorin e ftohjes dhe të pranimin të rregullave dhe zakoneve që parandalojnë rrjedhjen dhe evitimin e substancave që dëmtojnë Shtresën e Ozonit. Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Departamenti i Energjisë posedojnë një përvojë dhe pajisjet bazë të nevojshme për zhvillimin e kurseve të trainimit gjatë projektit dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë e tij derisa projekti të përfundojë.

Si rezultat i këtij projekti pritet së paku pakësimi 10% i konsumit të CFC – 12 nga 2002 deri në parandalimin e rrjedhjeve, ngritjen e një sistemi procedurash të pastrimit. Trainimi do të jetë më efektiv nëse lidhet me çertifikimin, liçensimin dhe programet e riciklimit dhe rikuperimit.

Ku projekt u organizua në disa faza.

Faza e parë tashmë është realizuar. Më 9 – 12 Mars 2004 u zhvillua një Workshop Trainues në Tiranë. Në të morën pjesë përfaqësues të huaj të UNEP – it dhe UNIDO –s, ekspertë Maqedonas dhe përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit.

Trainierët pjesëmarrës ishin: inxhinierë mekanikë dhe mjedisi, përfaqësues nga departamenti i mjedisit si dhe nga sektori i shërbimit të ftohjes. Ky workshop pati leksione dhe demostrime praktike. Pajisjet e nevojshme për demonstrim janë blerë dhe do të instalohen që të jenë të gatshme për fazën e dytë të projektit. Vëmendje të veçantë gjatë këtij trainimi iu dha përfaqësimit të përshtatshëm të trainierëve të ardhshëm nga rrethet e ndryshme të vendit për fazën tjetër të projektit, që do të mbulojë të gjithë vendin. Gjysma e pjesëmarrësve të fazës së parë do të drejtojnë trainimin në fazën e dytë. Në ditën e fundit të workshopit u bë edhe çertifikimi i pjesëmarrësve.

Në fazën tjetër trainierët e caktuar zhvilluan programin e trainimit të teknikëve të vendit.

Aktivitetet u kompletuan me synim që të sigurojnë që ky projekt të ketë një impakt real në sektorin e ftohjes.

## **2. Trainimi i Oficerëve të Doganave për Monitorimin e Lëndëve Holluese të Ozonit.**

Ky projekt financohet nga UNEP – i dhe është pjesë e rëndësishme e NOPIU – t. Ky projekt i kushtohet sigurisë së vlefshmërisë të të dhënave të mbledhura dhe të raportuara në Protokollin e Montrealit. Në Shqipëri janë rreth 17 pika doganore, megjithatë kontrolli është shumë i centralizuar. Ka një laborator që analizon produktet e importuara në Shqipëri. Ky laborator është në Tiranë dhe pranon pranon produkte nga pika të ndryshme doganore për t'i analizuar. Departamenti i doganave ka detyrë problemet për identifikimin e LHO dhe të raportimit, por sot ai di që ka probleme për identifikimin e LHO – ve dhe aktualisht nuk ka kontrole specifike për to.

Objektiva kryesore e këtij projekti është të forcojë kapacitetet e departamentit të doganave në kontrollin e import /eksportit të substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit dhe pajisjeve që i përmbajnë ose i përdorin ato nërmjet trainimit të oficerëve të doganave.

Në këtë trainim do të inkludohen stafi i departamentit të statistikës dhe Instituti i Statistikës që të sigurohet një grumbullim korrekt i të dhënave për import/eksportin e LHO – ve.

Në këtë workshop trainimi duhet të marrin pjesë dhe inspektorë rajonal, që do të kenë të bëjnë me identifikimin e tyre në vend.

Si rezultat i këtij projekti pritet:

- Përmirësi i kontrollit të importit dhe eksportit të LHO dhe pajisjeve që i përmbajnë ose i përdorin ato në Shqipëri.
- Vendosja e një database të import / eksportit, të importuesve, eksportuesve dhe përdoruesve të LHO (nga stafi i departamentit të statistikës së Drejtorisë së Doganave.).
- Përmirësimi i besueshmërisë të sistemit të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave të Protokollit të Montrealit nga NOPIU, duke krahasuar dhe analizuar importet e marra nga doganat me ato të inspektorëve vendor.
- Ulja e konsumit të LHO me rreth 3 ton/vit.

Projekti u zbatua në dy faza:

Në fazën e parë u bë trainimi i trainierëve. Në fazën tjetër do të zhvillohet një Workshop tre ditor, ku do të kërkohet që pjesëmarrësit të trainohen në identifikimin e pajisjeve që përmbajnë LHO dhe më pas të trajtohet sistemi i mbledhjes së të dhënave dhe monitorimit në lidhje me kërkesat, në një sistem të harmonizuar sipas Protokollit të Montrealit. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në workshop do të jetë rreth 30, të cilët dhe do të çertifikohen. Këto do të shërbejnë si trainierë në fazën e dytë.

Pajisjet e nevojshme për identifikimin e këtyre lëndëve janë blerë dhe me to do të pajisen pikat më të rëndësishme doganore.

Në fazën e dytë do të bëhet trainimi i oficerëve të doganave. Trainerët e trajnuar në fazën e parë do të shërbejnë si trajnerë për oficerët e doganave që nuk kanë marrë pjesë në fazën e parë. Informacion special në formë instruksioni do të përgatitet për oficerët e doganave.

- NOPIU do të kordinojë zbatimin e këtij projekti që të arrihen rezultatet e mëposhtëme:
- Laboratori Qëndror i Doganave (që ndodhet në Tiranë) duhet të angazhohet në një trajnim të vazhdueshëm për identifikimin dhe raportimin e LHO.
- Përfaqësuesit e departamentit të doganave duhet të jenë në workshop sidomos për legjislacionin dhe për identifikime problemeve kryesore të identifikuara gjatë vitit.
- NOPIU duhet të marrë pjesë për të zgjidhur problemet e implementimit dhe për të inkluduar këtë informacion në raportin e UNEP-it.
- NOPIU duhet të kordinojë aktivitetet me inspektorët vendor që të sigurohet se ata periodikisht mbledhin të dhëna reale të LHO në bazë.
- NOPIU periodikisht duhet të vizitojë pikat doganore dhe departamentin e doganave për të monitoruar dhe kontrolluar importin e LHO dhe të konfrontojnë statistikën e departamentit të doganave me të dhënat e inspektorëve vendor.
- Bazuar në të dhënat e importeve dhe përdorimit të tyre NOPIU raporton tek UNEP-i.

### **3. Workshop Ndërgjegjësimi për Parandalimin e Futjes së Metil Bromurit në Shqipëri.**

Ky workshop ka si agjensi implementuese UNIDO – n.

Workshopi u zhvillua në Tiranë më 26 – 27 Korrik 2004 dhe u realizua si rezultat i bashkëpunimit të UNIDO – s me Ministrinë e Mjedisit, NOPIU – t, Ministrinë e Bujqësisë dhe Institutit të Mbrojtjes së Bimëve. Ai synoi ndërgjegjësimin për mospërdorimin e Bromurit të Metilit për trajtimin e tokës dhe përdorimin e teknikave të tjera alternativeve jo të dëmshme. Në të morën pjesë kimistë dhe ekspert bujqësie (rreth 30 ). Workshopi ishte teoriko – praktik. Kështu teorikisht u demonstrua përvoja e vendit tonë ( nëpërmjet referimit të ekspertëve vendor mjaft të kualifikuar ) dhe ajo botërore ( nëpërmjet referimit të ekspertet së UNIDO – s, Znj. Popsimanova ). Përsa i përket demonstrimit praktik, ky u realizua në Green House këtu në Tiranë nga Prof.Dr. Vangjel Jovani. Në mbyllje të workshopit pjesëmarrësit u pajisën dhe me çetifikata

Në kuadër të këtij projekti është hartuar edhe broshura " Teknikat alternative të zëvendësimit të Metil Bromurit për luftimin e parazitëve në tokë".

**Mjedisi Shqiptar Nr 3/2004**

### Artikulli 3

## WORKSHOPI I RRJETIT RAJONAL TE OZONIT PER EVROPEN JUGLINDORE DHE AZINE QENDRORE.

### Përgatiti Valbona PLAKU - Asistente e Projektit të Ozonit, Maj 2008

Mbaroi me sukses Workshopi i Përvitshëm i Rrjetit Rajonal të Ozonit për Evropën Juglindore dhe Azinë Qëndrore, i cili për këtë vit u zhvillua në Tiranë më 25 - 28 Mars, në Hotel " Shato Linza ".

Në këtë workshop ndërkombëtar morën pjesë: përfaqësues të lartë të Sekretariatit të Ozonit, UNEP – it, UNIDO- s ( Agjenci financuese për Shqipërinë ), UNDP, ekspertë të ndryshëm nga Anglia, Gjermania, Hungaria, Rumania, Suedia, Austria, Franca, Polonia, ekspertë të MDI – ve dhe të sektorit të shëndetit, koordinatorë dhe asistent- koordinator të Ozonit të vendeve të Evropës dhe Azisë Qëndrore, rreth 70 pjesëmarrës nga më shumë se 30 vende të Botës.

Për herë të parë në një workshop ndërkombëtar u bë përkthim simultant anglisht – rusisht dhe rusisht – anglisht.

Në këtë seminar nderoi me ardhjen e Tij edhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Z.Lufter XHUVELI dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj Ministrie, i cili mbajti dhe fjalën e hapjes të këtij seminari të rëndësishëm.



Më pas përshëndetën Z. Gilbert BANKOBEZA nga Sekretariati i Ozonit dhe Z. Blaise Horisberger nga UNEP- i.

Në vijim u bë mbjellja e rreth 60 rrënjë pemëve nga pjesëmarrësit e seminarit si simbol i sinergjisë së këtij Projekti me Projektin e Ngrohjes Globale.



Ky seminar u zhvillua për gjatë katër ditëve, ku si tematikë kryesore në ditën e parë ishte ndikimi i përdorimit të CFC – ve në aerosolet farmaceutike që përdoren për të sëmurët azmatikë.

Në ditën e parë kishte referim nga vendi ynë për këtë tematikën Znj. Rilinda KLOSI – Shefe e Laboratorit të Kontrollit të Barnave.

Si synim i gjithë këtij referimi ( së ditës së parë ) është ndërtimi i një strategjie dhe përmirësimi i legjislacionit të preperateve azmatike.

Në ditën e dytë si tematikë kryesore ishte roli i HCFC – ve, alternativat e reja zëvendësimit të tyre në sektorët e industrisë si, shkumës dhe ftohjes.

Në ditën e tretë si tematikë kryesore ishte strategjia dhe legjislacioni për HCFC – të, dhe sistemi i liçensave për import – eksportin përfshirë edhe HCFC- të.

Për këtë tematikë kishte referime nga ekspertët më të mirë të Evropës. Për vendin tonë në lidhje me HCFC – të u kërkua krijimi i një Plani Kombëtar për heqjen nga përdorimi të tyre me të njëjtën procedurë si edhe për CFC – të: pra karakterizimi i konsumit dhe përdorimit të HCFC – ve në vend, zhvillimi i një sistemi dokumentimi për shpërndarësit dhe konsumatorët e këtyre substancave, përcaktimi i kuotave të konsumit për çdo vit, ndërtimi i një sistem liçensimi për import – eksportin e HCFC - ve, përmirësimi i legjislacionit që nënkupton edhe vendosjen e sanksioneve sikurse është bërë në vendin tonë deri tani për CFC – të.

Gjithsej u prezantuan më shumë se 70 referime.

Dita e katërt u përmbush nga diskutime në grupe të vogla për sistemin e liçensave, dhe për prioritetet e vitit 2008- 2009, zbatimi i programit të punës së ECA 2007 – 2008 si edhe Draft programi i punës, përcaktimi i buxhetit, dhe tematikat për ECA 2008 – 2009 dhe përcaktimi i vendit për zhvillimin e seminarit në vitin e ardhshëm.

Seminari u mbyll me rekomandime dhe konkluzione të ECA Network Meeting.

## **2. Prezantime në seminare kombëtare dhe ndërkombëtare.**

- a. Prezantime në seminare kombëtare.
- b. Prezantime në semionare ndërkombëtare.

### **3. Programe dhe Spote televizive**

Eshte bërë një spot ndërgjegjësimi në TV News 24

### **4. Gjithashtu janë bërë 2 emisione në News 24 dhe Top Chanel per Ozonin.**

Në TV News 24 ky emision është transmetuar më 17.01.2007.

Në TV Top Chanel emisioni u transmetua më 30.01.2007.